

KUSHTET E SIGURIMIT TE MJETIT MOTORIK (KASKO)

TERMA TE PERGJITHSHME

- "Vendqendrim i Mjetit Motorik" kuptohet ambjenti i prezences me te madhe gjate qendrimit te Mjetit Motorik, i zones se tij te vendbanimit, punes apo parkimit.
- "Mjet Motorik" kupton nje mjet motorik vetlevizes, tokesor, i projektuar per perdorim ne rruget publike, qe perfshihet ne klasifikimin e bere.
- "Perdoruesi" kupton anetaret e familjes te te Siguruarit qe bashkejetojne me te, por jo studentet dhe ushtaraket me vendbanim ndryshe nga i tij, bashkepunetoret e tij por jo me shume se dy persona, emrat e te cileve shenohen detyrimisht ne kerkesen per sigurim dhe deshmine e sigurimit, te cilet perdorin mjetin motorik dhe per te cilet eshte i vlefshem mbulimi ne rast sigurimi.
- "Mjet Motorik i Siguruar" kupton mjetin motorik ose rimorkion per te cilen eshte paguar primi i sigurimit dhe eshte zgjedhur periudha dhe mbulimi perkates.

PERIUDHA E ZGJATJES SE KONTRATES

Kjo kontrate aplikohet vetem per deme dhe humbje te cilat ndodhin gjate periudhes se treguar ne Deshmine e Sigurimit. Ne qofte se nuk percaktohet ndryshe, periudha e zgjatjes se kontrates eshte nje vjecare. Ndryshimi i periudhes se zgjatjes se kontrates shoqerohet me ndryshimin e primit te sigurimit, treguar ne tarifat e primit. Kontrata me afat me te shkurter se nje vit nuk rinovohet dhe nuk zgjatet.

3. SHTRIRJA TERITORJALE

Kjo kontrate aplikohet vetem per humbje qe ndodhin ne zona te ndryshme te territorit te Republikes se Shqiperise. Zgjerimi i territorit mund te behet me marreveshje, vetem ne qofte se i Siguruari eshte siguruar sipas mbulimit 1 dhe 2, per nje periudhe nje vjecare, duke e treguar ne policen e sigurimit. Kjo marreveshje nuk ka te beje me numrin e udhetimeve apo kohzgjatjen e tyre. Ndryshimi i territorit do te shoqerohet me ndryshimin e primit te sigurimit dhe tregohet ne tarifat e primit te sigurimit.

4. OBJEKTI I SIGURIMIT

Do te jene demet e plota ose te pjeshme per cdo mjet motorik te modeleve standarte me komponentet dhe aksesoret e detyrueshem ose te rekomanduara per rritjen e sigurise, te pershkruara ne kerkesen per sigurim, per shkak te rreziqeve te zgjedhura dhe te pranuar.

MBULIMI 1

SIGURIMI I PERPLASJES

Siguruesi do te paguaj demet e paguara si rezultat i perplasjes ose permbysjes aksidentale me nje mjet motorik ose objekt tjetër. Siguruesi do te paguaj deri ne limitin e pergjegjesise per demet qe jane mbi pjesen e zbritshme.

MBULIMI 2

SIGURIMI I PERGJITHSHEM

Siguruesi, me kete mbulim pervec mbulimit 1 do te paguaj humbjet ose demet ne mjetin motorik te siguruar. Siguruesi do te paguaj humbjet ose demet e shkaktuara nga:

- Rrenja e objekteve te jashtme mbi mjetin motorik te siguruar
- zjarri ose eksplozioni
- termeti
- stuhia dhe rufeja
- rreshqitja e tokes ose permbytja
- debora dhe bresheri
- thyerja e xhamit

Ne kete police termi " Humbje nga Zjarri", do te kuptoje zjarrin e shkaktuar nga shkaqe te jashtme, qe vetperhapen duke perfshire mjetin motorik te siguruar.

Siguruesi do te paguaje humbjet ose demet duke reduktuar pjesen e zbritshme te treguar ne policen e sigurimit.

Ne kete deshmi termi " thyerje xhami", do te kuptohet qe nga plasaritja deri tek thermimi i xhamave te qarte, transparent, me perberje te forte plastike, te parme, te prapem, te perfshire ne katalogun e prodhimit si rezultat i veprimeve te jashtme aksidentale me ose pa demtimin e vete mjetit motorik te siguruar. Siguruesi nuk do te paguaj per demet ose humbjet, qe jane me te vogla se pjesa e zbritshme.

Siguruesi do te paguaje humbjet ose demet, duke reduktuar pjesen e zbritshme te treguar ne policen e sigurimit.

MBULIMI 3

SIGURIMI I PLOTE

Siguruesi, me kete mbulim pervec mbulimit 1 dhe 2 me siper, do te paguaj demet ne mjetin motorik te shkaktuar nga **Vjedhja e Grabitja**

Ne kete police termi " humbje ose vjedhje nga grabitja" do te kuptohet cdo veprim i kunderligjshem nga nje ose disa persona kundrejt mjetit motorik te mbyllur me se miri ose ne vendqendrimin e tij per: